



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI**

Nr. 1809 prot.

Pogradec, më 17.04.2024

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

**Znj.MANJOLLA KAMOLLI
KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK**

E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues, projektin e hartuar, hartat pyjore të ekonomisë për: “Miratimin paraprak të hartimit të Planit të Menaxhimit Ekonomia Pyjore Mokër 1”.

Me respekt,

KRYETARI

Ilir XHAKOLLI

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2

Nr. i faqeve A4 të relacionit shoqërues të projekt vendimit: 2

Nr. i faqeve A4 të relacionit teknik shpjegues 7

Nr. i fletëve A4 të dokumenteve të projektit plani mbarshtimi moker 1: 436

Nr. i faqeve A1 të hartave të Ekonomisë Pyjore Mokër 1: 5



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. ____ Prot.

Pogradec, më ____ . ____ 2024

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____, DATË ____ . ____ .2024

“PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË EKONOMISË PYJORE
MOKËR 1

Të nderuar këshilltarë !

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të Ligjit Nr.57/2020, datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, neni 11, pika 2, gërma b, sipas citimit “.. për të gjitha format e pronësisë planet e mbarështimit miratohen nga Ministri. Përjashtimisht për bashkitë, miratimi i planit të mbarështimit shoqërohet me miratimin paraprak të këshillit bashkiak përkatës..”, të Udhëzimit Nr.01, datë 26.01.2017 “Për mbajtjen e Kadastrës së Fondit Pyjor dhe Kullësor Kombëtarë”, të kontratës Nr.342/11, datë 15.08.2023 “Kontratë Shërbimi”, lidhur ndërmjet Ndërmarrjes Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike, Bashkia Pogradec dhe subjektit “**Joklen & CO Shpk**” sh.p.k, Pogradec-Albania, me Nipt **K84322601F** me adresë: “Rruga Rinia, lagjia nr.2, pallat, kat 1, zona kadastrale nr.8581, numur pasurie 4/4, pogradec”, përfaqësuar nga administratori Maliq Misliu, objekt: “Hartim Plani Mbarështimi i dhe menaxhimi ekonomia pyjore Mokër 1. Bashkia Pogradec me propozim të Kryetarit të Bashkisë dhe Drejtorisë së Shërbimit Mbrojtjes së Pyjeve dhe Kullotave pasi u shqyrtua relacioni i përgatitur nga Administrata e Bashkisë ku është argumentuar teknikisht dhe ligjërishit, i kërkohet Këshillit Bashkiak të Bashkisë Pogradec që në mbledhjen e datës ____ . ____ .2024 të miratojë:

VENDOSI:

1. Të miratojë Planin e mbarështimit të ekonomisë pyjore Mokër 1 të hartuar nga Subjekti Joklen & CO Shpk me NIPT **K84322601F**.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Pogradec, Drejtorja e Shërbimit Mbrojtjes së Pyjeve dhe Kullotave, Drejtorja e Çështjeve Juridike, Drejtorja Ekonomike dhe Menaxhimit Financiare.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
4. U shpall sot më datë _____.____.2024.



KRYETARE E KËSHILLIT TË BASHKISË

MANJOLA KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më _____.____.2024

RELACION PËR PROJEKT- VENDIMIN
ME OBJEKT:

“PËR

MIRATIMIN E PLANIT TË MBARSHITIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE
EKONOMIA PYJORE MOKËR 1”.

**E NDERUAR KRYETARE E KËSHILLIT!
TË NDERUAR KËSHILLTARË!**

KREU I

HYRJA DHE PËRSHKRIMI I VEPRIMTARISË

Ndër të tjera, pranë Bashkisë Pogradec është e krijuar dhe funksionon Drejtoria e Shërbimit Mbrojtjes së Pyjeve dhe Kullotave, në të cilën janë të përqëndruara pothuajse të gjitha funksionet e deleguara nga Pushteti Qëndror, të cilat janë:

1. *Shërbimi Pyjor.*
2. *Inspektoriati i Pyjeve*
3. *Sektori i Kullotave.*

Administrimi i i fondit pyjor dhe kullor në territorin e Bashkisë Pogradec është një ndër funksionet e Bashkisë, i përcaktuar në nenin 27 të ligjit nr.139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, ku në pikën 5 të këtij neni përcaktohet: "**Funksionet e Bashkive në fushën e buqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit:** Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve pika 5. *Administrimin e fondit pyjor dhe kullor publik, sipas legjislacionit në fuqi.*

KREU II

INTERPRETIMI I BAZËS LIGJORE

Referuar pikes 5 te nenit 27 te Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:

5.Administrimin e fondit pyjor dhe kullor publik, sipas legjislacionit në fuqi.

Procedura për Miratimin e planeve të Mbarshtimit mbështet në pikën 2/b nenit 11 të Ligjit Nr. 57/2020, "Për pyjet" Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.398 datë 13.05.2020 për disa ndryshime ne vendimin Nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave e bashkive", VKM Nr.171, datë 18.3.2022 "Për ngritjen e bazës së të dhënave për regjistrin kombëtar të fondit pyjor dhe regjistrin e fondit kullosor, përcaktimin e strukturës, kritereve teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mënyrës së mbajtjes së të dhënave në nivel vendor, rajonal e qendror, informacionit që duhet regjistruar, si dhe të afateve të përgatitjes e raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve", si dhe referuar Udhëzimit Nr.1 Datë 26.01.2017 "Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullosor Kombëtar", pika 1, 5 citohet: *plani mbarshtimit/inventarizimit është baza e të dhënave për treguesit e fondit pyjor dhe kullosor.*

Mbështetur në legjislacionin pyjor në fuqi për pyjet, tregues për gjëndjen e fondit pyjor realizohet vetëm nëpërmjet hartimit të dokumentave strategjik për pyjet, në rastin konkretë, hartimin e planeve të mbarshtimit dhe inventarizimit në nivel ekonomive pyjore, e cila është njësia me e madhe e administrimit dhe menaxhimit të fondit pyjor.

Per sa me siper, duke krijuar bindjen që projekt vendimi është ne perputhje me te gjitha detyrimet ligjore dhe se dokumentacioni shoqerues eshte i plote, Jini te lutur te miratoni projekt vendimin bashkengjitur.

Duke shpresuar në miratimin e këtij materiali nga ana Juaj,

PËRGATITI MATERIALIN:

Konceptoi: SPECIALIST

KLEDI LUFO



Pranoi: DREJTOR

KLEDI ÇELA

Miratoi: SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

DRITAN BABASULI

Konfirmoi: KRYETAR

ILIR XHAKOLLI





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. ___ Prot

Pogradec, më __. __. 2024

RELACION
PËR PROJEKT – VENDIMIN ME OBJEKT

“PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË MBARSHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE
EKONOMIA PYJORE MOKËR 1.

I NDERUAR KRYETAR I KËSHILLIT !

TË NDERUAR KËSHILLTARE !

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, po Ju dërgojmë për shqyrtim dhe marrjen e vendimit përkatës, këtë relacion, me përmbatje si më poshtë:

Baza Ligjore:

Në mbështetje të nenit 3, nenit 8, të pikes 1 nënpika 1.1, shkronja “a” të nenit 9, nenit 27 pika 5, nenit 54 shkronjat “k” të ligjit Nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; neni 11 pika 2/b e ligjit Nr.57 datë 30.04.2020 “Për Pyjet; ligjin Nr.5/2016 “Për shpalljen e monatoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.398 datë 13.05.2020 për disa ndryshime në VKM nr.433 datë 08.06.2016 “Për transferimin sipas listës së Inventarit të pyjeve dhe kullotave publike, aktualisht në administrimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në pronësi të ish Komunave/bashkive”,

Bashkia Pogradec në kuadër pjesë të funksioneve të saj, ka dhe administrimin e qëndrueshëm të fondit pyjor/kullosor kjo sipas listës të përcaktuar me ligj, Sipërfaqja pyjore që administron Bashkia Pogradec bazuar në VKM nr.398 datë 13.05.2020 për disa ndryshime në VKM nr.433 datë 08.06.2016 “Për transferimin sipas listës së Inventarit të pyjeve dhe kullotave publike, aktualisht në administrimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në pronësi të ish Komunave/bashkive janë gjithsej **26369.88 ha.**

Në zbatim të kontratës nr.342/11 datë 15.08.2023 “Kontratë Shërbimi” me objekt: “Hartim plani, mbarshtim dhe menaxhimi ekonomia pyjore Mokër 1” nga subjekti “**Joklen & CO Shpk**”



sh.p.k, Kontratë shërbimi Mbikqyrje Nr.412/7 datë 15.08.2023 me objekt: “Supervizioni i objektit Hartim plani, mbarshtrim dhe menaxhimi ekonomia pyjore Mokër 1” nga subjekti **Lurimi Shpk**, Urdhëri Nr.120 datë 15.08.2023 “Për monitorimin e zbatimit të kushteve të kontratës dhe marrjes në dorzim të shërbimeve të realizuara të objektit: “Hartim plani, mbarshtrim dhe menaxhimi ekonomia pyjore Mokër 1”, Çertifikim i Planit të Mbarshtrimit nr.740/2 datë 15.12.2023 me Objekt: “Hartim plani, mbarshtrim dhe menaxhimi ekonomia pyjore Mokër 1” nga Subjekti **Xhet Shpk**, si dhe Proces-Verbal nr.1 datë 15.12.2023 “Për marrjen në dorzim përfundimtar, të realizimit të shërbimit në objekti: “Hartim plani, mbarshtrim dhe menaxhimi ekonomia pyjore Mokër 1”.

Gjatë marrjes në dorzim dhe vlersimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të fondit pyjor dhe kulloror që ka kaluar në pronësi të Bashkisë Pogradec është konstatuar se plani e mbarshtrimit rezulton që është hartuar Ekonomia pyjore “**Moker 1** është mbarështuar për herë të fundit në vitin 1985, ekonomia gjatë këtyre viteve ka pësuar ndryshime të medha dhe mjaft të ndjeshme, si për sa i përket strukturës ashtu dhe shpërndarjes së vëllimit sipas klasave të moshës dhe prodhimit, prandaj duke u nisur nga këto arsye dhe njëkohesisht duke mos mohuar për punën e bërë për hartimin e planit të vjeter kalimi i një pjese të kësaj ekonomie nga prone shtetërore në pronësi të bashkisë, ku kërkesat për hartimin e këtij plani është rritur, pra për aresyet e mësipërme u pa e domozdoshme hartimin e këtij plani i cili do të pasqyrojë gjëndjen reale të grumbujve, duke i parë në këndvështrime të ndryshme si ajo e prodhimitarise, ruajtjes së terrenit dhe me një seriozitet është studjuar gjëndja e vleresimi i biodiversiteti në përgjithësi.

Plani mbarështimit të kesaj ekonomie është hartuar në bazë të manualit të mbarështimit të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit si për punimet e terrenit ashtu dhe për ato të zyrës. Në këtë plan mbarështimi një vend të rëndësishëm zë sigurimi i një mbarështimi të qëndrueshëm dhe shumë funksional i pyllit.

Objektivi i pergjdhshem eshte perdorimi dhe zhvillimi i qendrushem i pyjeve, mbi bazen e kerkesave bashkekohore te gjendjes biologjike dhe ekollogjike te tyre me qellim qe te percaktohen realisht ponteciali i tyre prodhus, duke mbrojtur biodiversitetin dhe mjedisin. Eshte synuar nderthurja e te gjithë faktoreve qe lidhen direkt dhe indirekt midis tyre p.sh popullatat lokale, administrimi i pyjeve dhe kullotave, ekoturizmi, permiresimi i pejsazhit rural,ruajtjen e natyres. Po ashtu do te synohet plotesimi i kerkesave me lende ndertimi dhe e dru zjarri, prodhime te dyta pyjore, baze ushqimore per blegtorine.

Këto plane aktualisht janë të pavlefshme në reference të ligjit nr.57/2020 “Për pyjet” i cili ka përcaktuar afatin maksimal të vlefshmërisë së planeve të mbarshtrimit 10 vjeçar.

Mbarështimi i pyjeve realizohet në përputhje me politikat dhe Programin Kombëtar të Pyjeve, duke garantuar ruajtjen, zhvillimin dhe ripërtëritjen e fondit pyjor kombëtar, sigurimin e kushteve për zhvillimin e tij në përputhje me prioritetet kombëtare.

Mbarështimi i pyjeve përshtatet dhe plotësohet në përputhje me ndryshimet e gjendjes së fondit pyjor kombëtar, si dhe me ndryshimet shoqërore dhe ekonomike të vendit. Shfrytëzimi dhe përdorimi i resurseve natyrore është vleresimi i drejte i pyjeve të kesaj ekonomie, ne te njeften



kohe eshte dhe nje hap para dhe si faktor i domosdoshem per ruajtjen e ekulibrit te mjedisit, ne te njejten kohe eshte dhe nje rregullator i mirefillte ne ruajtjen e regjimit hidrik. Eshte detyre paresore qe me zbatimin e masave silvoteknike qe do te hartohen e zbatohen ne kete plan mbareshtirim qe grumbujt pyjore te arrijne qellimin kryesor e final, sipas regjimit te tij.

Synimet qe do te arrien ne zbatimin e ketij plani jane:

- Hartimi i masave silvoteknike ne trajtimin e pyjeve qe do te shprehet dhe ne rritjen e prodhimtarise e te gjitha elementet e duhur.
- Menaxhimi me kriteret e efekshme ekonomike me efektivitet te qendrueshem ekonomik gjate shfrytezimit racional te burimeve netyrore
- Hartimi dhe miratimi i ketij projekti eshte baza e fillimit te ushtrimit te masave silvoteknike, dhe kryerja e nje menaxhimi te mirefillte te te ardhurave ekonomike, e nje te ardhme te nje grumbulli pyjor me parametra te prekshem.

Gjate tranzicionit dhe periudhes se tanishme, pyjet nuk jane trajtuar mire sipas planeve te mbareshtimit, ne pergjithesi pyjet jane demtuar nga prerjet pa leje, kjo vjen si rezultat i mungeses se lendes djegese (dru zjarri), dhe varferise te komunitetit qe jeton brenda ekonomise pyjore.

Planeve te mbarështimit të ekonomive pyjore, si dokument bazë afatgjatë për pyjet, për realizimin e qeverisjes, zhvillimin dhe mbrojtjen e tyre, i vlefshëm për një periudhë 10-vjeçare. Planet e mbarështimit hartohen nga pronarët përkatës sipas formës së pronësisë, bazuar në metodikat/udhëzuesit e përgatitur nga ministria, nëpërmjet ekspertëve të certifikuar të fushës ose strukturave pyjore. Për të gjitha format e pronësisë, planet e mbarështimit miratohen nga ministri. Përfundimisht për bashkitë, miratimi i planit të mbarështimit shoqërohet me miratimin paraprak të sektorit të pyjeve e kullotave të bashkise përkatëse:

Fondi pyjor dhe kullosore sipas ekonomive pyjore si dhe kategoritë e përdorimit të tokës brenda territorit të ekonomisë pyjore Mokër 1.

Të dhënat kryesore sipas planit të mbarshtrimit 2024-2034


Përdorimi i terriorit

| Perdorimi i teritorit | Aktuale, siperfaqia /ha | E propozuar siperfaqia/ha |
|-----------------------|-------------------------|---------------------------|
| Bashkikake | | |
| Pyll | 4431.0 | 4431.0 |
| Sip.me bimesi pyjore | 5.4 | 5.4 |
| Bujqesi | 4712.6 | 4712.6 |
| Kullota, livadhe | 207.6 | 207.6 |
| Urbane(truall) | - | - |
| Ujore | - | - |
| Shkembore | - | - |
| Djerr | 5.8 | 5.8 |
| Joproductive | 45.2 | 45.2 |
| Totali: | 9407.6 | 9407.6 |

Sipas tabelës së më sipërme të përdorimit të territorit kemi ndryshime lidhur me sipërfaqen dhe tipet aktuale të përdorimit të tokës. Edhe në të ardhmen sipërfaqja pyjore, kullimore e bujqësore nuk do të ndryshojnë.

Format e qeverisjes

| Perdorimi i teritorit | Aktuale, sipërfaqja /ha | E propozuar sipërfaqja/ha |
|-------------------------|-------------------------|---------------------------|
| Shtetërore, bashkiake | | |
| Trungishte | 103.3 | 103.3 |
| Cungishte | 4024.8 | 4024.8 |
| Trungishte e parregullt | 51.6 | 51.6 |
| Cungishte perbere | - | - |
| Shkurre | 251.4 | 251.4 |
| Kullote, livadh | - | - |
| Kullote me drure | - | - |
| Kullote me shkurre | - | - |
| Shuma: | 4431.0 | 4431.0 |



Rezultate të mësipërme shprehin që sipërfaqet e pyjeve kanë ndryshime, për shkak të matjes në terren nga metoda e përdorur për hartimin e projektit, duke e krahuar me metodat e vjetra që janë përdorur për hartimin e planeve të mbareshtrimit, por tendenca për shtesë ka sepse suksesioni progresiv ka bërë dhe po bën e punën e vet duke mbuluar kullotat dhe tokat djerr me

pyll, ndersa prerjet pa kriter ne rast se vazhdojne me kete ritem do te pakesohet siperfaqia e trungishtes do te vije duke u pakesuar.



Funksionet kryesore te pyjeve.

| Funksioni | Aktuale,siperfaqia/ha | Propozuar,siperfaqia/ha |
|-------------------|-----------------------|-------------------------|
| Prodhues | 3500.5 | 3500.5 |
| Mbrojtes-prodhues | - | - |
| Mbrojtes | 930.5 | 930.5 |
| Konservim | - | - |
| Rekreacion | - | - |
| Totali: | 4431.0 | 4431.0 |



Duke e pare problemin sipas koncepteve te reja te mbareshtimit eshte menduar qe disa parcela te kalojne me funksion mbrojtes. Pra ka një ndryshim te raportit te pyjeve prodhues me ata mbrojtes ku 79 % e pyjeve jane propozuar pyje prodhues dhe 21 % jane pyje mbrojtes.

Në këtë ekonomi janë parashikuar masa të ndryshme silvikulturore si pyllëzime me fidana në siperfaqet djerr dhe siperfaqet me bimesi pyjore me sipërfaqe totale 56.6 ha me llojin Akacie për rehabilitimin e erozionit si dhe Pisehe e zeze..

Tipet e kullotave

| Tipi i kullotes | Sipërfaqia /ha | % ndaj sipërfaqes Totale te kullotes | % ndaj sipërfaqes totale te ekonomise |
|------------------|----------------|--------------------------------------|---------------------------------------|
| Kullote verore | 207.6 | 5.3 | 4.4 |
| Kullote dimerore | - | - | - |

Ne ekonomine pyjore Moker 1 perfshihet nje sipërfaqe prej 207.6 ha kullota alpine Ballkanike. Periudha e kullotjes eshte vetem gjate veres. Per shkak te numurit te krereve te bagetise dhe perdorimit kolektiv te saj ka nje rendim te kullotes. Shfrytezimi behet duke u dhene liri kopeve te dheneve te gjejne ushqim sipas deshires se tyre ne te gjithe sipërfaqen dhe per gjithe sezionin kullisor. Masat në kullota të cilat ndodhen mbrenda pyllit janë planifikuar masa të ndryshme kryesisht pastrim gurësh me një sipërfaqe dhe heqje barerash te keqija me sipërfaqe 205.78 ha dhe pastrim gurësh 1.82 ha.

Janë bërë parashikime për nderhyrjet me karakter silvoteknike si: çlirime, pastrime, Rrallime te tipit të pare dhe të dyte në pyje Cungishte, me sipërfaqe 2975.7 ha dhe volum që do të nxirret nga këto nderhyrje 9702.7 m³. Rrallime te tipit te pare 252 ha, volumi qe do te nxirret 932.6 m³, rrallim e tipit te dyte 50.8 ha, volume që do të nxirret 171 m³. Pastrime do te kryhen 2039.9 ha me nje volum prej 6472.1 m³, ricungime 232.7 ha me nje volum prej 2127 m³ ne pyjet e demtuara nga prerjet pa leje. Këto rrallime do të aplikohen me intensistete të ulët dhe të mesëm i prerjeve.

Totali i ekonomisë pyjore si volum të përgjithshëm të materialit drusor eshte 92312 m³, e ndarë në lendë punimi të trashë, mesme, hollë dhe dru zjarri. Materiali drusor që do të nxirret nga nderhyrjet silvoteknike me intensitet të ulta dhe pak të mesme në planin 10 vjeçar të punimeve.

Gjithashtu në këtë ekonomi pyjore janë planifikuar dhe ndërhyrje në infrastructure si: rehabilitim rrugësh, ndërtim kanalesh, vendosje tombinosh etj, kjo si rezultat i përmirsimit të mbritshmërisë pyjore mbrenda ekonomisë.

Referuar përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi, fondi pyjor dhe kullisor qeveriset bazuar në planet e mbarshimit që përbëjnë dokumentet bazë për mbarshimin e një ekonomie pyjore, që përmban analizën e gjëndjes së pyjeve, përcakton objektivat që duhet të realizohen në funksion të statusit që kanë, si dhe planifikon masat për trajtimin e tyre dhe ndërhyrjet për vitet e ardhshme.

Plani i ri i mbarshimit të ekonomisë pyjore përcaktohen hapat që do të ndiqen për zhvillimin e pyjeve dhe kullotave për një periudhë 10 vjeçare, duke i hapur rrugë në këtë menyrë investimeve në fodin pyjor dhe kullisor nëpërmjet:

- a) Pyllëzimeve të reja dhe rehabilitimit të zonave të dëmtuara
- b) Shfrytëzimit të qëndrueshëm të pyjeve për nevojat publike
- c) Rritjen e mundësive për mbrojtjen e shtresës së tokës nga gërryrtet/ erozioni

d) Rritjen e prodhimit të lendës drusore

Nga ana tjetër përmes këtij procesi arrijmë të realizojmë plane të tilla për pyjet, të cilët janë një bazë e mirë për certifikimin e pyjeve të bashkisë bazuar në rregulloret FLEGT dhe EUTR të BE-si dhe ligjin Nr.57 datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, duke garantuar në këtë mënyrë zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve në territorin e bashkisë.

Aktivitetet e planifikuara për periudhën 10-vjeçare, të identifikuar sipas planeve të reja të mbarështimit, për çdo ekonomi pyjore janë;

1. Ekonomia pyjore “Mokër 1”

Cungishte (Pyje lisi), trajtimet silvikulturale (përmirsuese që do të aplikohen) si më poshtë:

- ✓ Pastrime 2039.9 ha me një volum 6472.1 m³
 - ✓ Rrallime tipi i parë 252.4 ha me një volum prej 932.6 m³
 - ✓ Rrallime tipi i dytë 50.8 ha me një volum prej 171 m³
 - ✓ Ricungime 232.7 ha, me një volum 2127 m³
- Pyllezime me fidana 56.6 ha (lloji Akacie dhe Pishë e zezë).

Përmirësim kullote,

- heqja e barërave të këqija, shkulje shkurresh, me një sipërfaqe 205.78 ha
- pastrim dhe grumbullim gurësh me një sipërfaqe 1.82 ha

Ndërhyrje në infrastrukturë

- Rehabilitim rruge auto, ndërtim kanalesh, vendosje tombino etj, me një gjatësi prej 13.2 km, dhe vlerë prej 680000 lek.

Referuar nenit 11, pika 2 shkronja “b” të ligjit 57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, përcaktohet se planet e mbarështimit të ekonomive pyjore si dokument bazë afat gjatë për pyjet, për realizimin e qeverisjes, zhvillimin dhe mbrojtjen e tyre, i vlefshëm për një periudhë 10-vjeçare, hartohen nga pronarët përkatës sipas formës së pronësisë, bazuar në metodikat/udhëzuesit e përgatitur nga ministria, nëpërmjet ekspertëve të certifikuar të fushës ose strukturave pyjore. Për të gjitha format e pronësisë, planet e mbarështimit miratohen nga ministri. Përfundimisht për Bashkitë, miratimi i planit të mbarështimit shoqërohet me miratimin paraprak të këshillit bashkiak përkatës.

Në këto kushte, Drejtoria e Shërbimit Mbrojtjes së Pyjeve dhe Kullotave në cilësinë e strukturës përgjegjëse për administrimin e çështjeve që lidhen me hartimin e politikave dhe planeve për mbrojtjen, zhvillimin, shfrytëzimin e kontrolluar të fondit pyjor e kulloror pjesë e territorit të Bashkisë Pogradec, me qëllim arritjen e objektivave të saj strategjike dhe përmbushjen e rezultateve të kërkuara nga kjo njësi organizative, ***i propozon Këshillit Bashkiak Pogradec për miratimin paraprak si dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në***

cilësinë e organit vendimarrës, miratimin përfundimtar të Projekt Draft planit të mbarështimit të ekonomise pyjore Moker 1.



1. Mbarshtimi është planifikimi afatëgjatë për pyjet, publike dhe private, i cili kryhet në bazë të kriterëve të caktuara për grumbullimin e informacionit për situatën/ gjëndjen faktike dhe përcaktimin e objektivave e masave të nevojshme, në funksion të statusit të dhënë, me synim përmbushjen e funksioneve ekologjike, ekonomike e sociale, duke zbatuar dhe harmonizuar parimet e zhvillimit të qëndrueshëm me nevojat administruese, pronarëve privatë dhe përdoruesve të tyre.
2. Ekonomi pyjore është njësi bazë e organizimit të sipërfaqes së fondit pyjor kombëtar për qeverisjen e pyjeve dhe drejtimin, planifikimin e kontrollin e mbarshtimit të pyjeve, që zakonisht përfshin një masiv pyjor, me kufij të qartë natyrorë.

Duke shpresuar në miratimin e këtij materiali nga ana Juaj,

PËRGATITI MATERIALIN:

Konceptuan:

Specialist Pyjesh:

Ing. KLEDI LUFO

Pranoi:

PËRGJEGJËS SEKTORI

Ing. ARBEN BRAHO

Miratoi:

DREJTORI

KLEDI ÇELA

Konfirmoi:

KRYETAR

ILIR XHAKOLLI